



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-063

Prishtinë, më 29 mars 2019, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 29 MARS 2019

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Kujtim Shala dhe Aida Dërguti, nënkryetarë të Kuvendit.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Valmir Klaiqi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi dhe Musli Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit të Kuvendit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Plotësimi i rendit të ditës për vazhdimin e seancës plenare, e caktuar për 11 prill 2019: Kërkesa Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë shtetasve turq për vazhdimin e mandatit edhe për një afat 30-ditor.

Kryetari i njoftoi të pranishmit se Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 28 mars 2019, ka vendosur që vazhdimi i seancës plenare me pikat e papërfunduara të mbahet me 11 prill, ndërsa seanca e re më 12 prill 2019.

Ai propozoi që rendi i ditës për vazhdimin e seancës plenare më 11 prill 2019 të plotësohet edhe me këtë pikë: Kërkesa Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë shtetasve turq për vazhdimin e mandatit edhe për një afat 30-ditor.

Kryetari e hapi diskutimin lidhur me propozimin e lartshënuar.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozimin e kryetarit, njëzëri vendosi kërkesa e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë shtetasve turq për vazhdimin e mandatit edhe për një afat 30-ditor të radhitet si pikë e katërt (4) e rendit të ditës për vazhdimin e seancës plenare, më 11 prill 2019.

2. Të ndryshme

Nënkryetari i Kuvendit, Xhavit Haliti, e shtroi çështjen e komisioneve parlamentare që po i thërrasin drejtuesit e agjencive ligjzbatuese për të raportuar në komision jashtë fushës së përgjegjësive që i kanë komisionet parlamentare.

Kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, propozoi që portretet e ish-kryetarëve të Kuvendit të vendosen në sallën C-301.

Kryesia e mbështeti propozimin e kryetarit që portretet e ish-kryetarëve të Kuvendit të vendosen në sallën C-301.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 12:35 minuta.

Kryetari i Kuvendit:
Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*